



## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME NGA TRYEZA E RRUMBULLAKËT „Mundësitë ekonomike për gratë në nivel lokal,,

E mbajtur në Shkup, 27 prill, 2016

34 aktiviste, hulumtuese dhe përfaqësuese të pushtetit lokal nga Maqedonija dhe Kosova, në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Shoqata për promovimin e barazisë gjinore-Akcija Zdruzenska, më 27 prill 2016 në hotel “Solun” në Shkup, debatuan për sfidat kryesore dhe i rishikuan/rrishqyrtuan politikat aktuale për përmirësimin e kushteve ekonomike për gratë në nivel lokal.

Tryeza e rrumbullakët u realizua në kuadër të Projektit “Barazia dhe Përfaqësimi Gjinor Përtej Kufijve”, i mbështetur nga BE në kuadër të IPA instrumentit për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Projektin e realizon Akcija Zdruzenska, në partneritet me Qendrën për studime gjinore të Kosovës, Institutin për zhvillim të komunitetit nga Tetova dhe Qendrën për këshillim dhe mbështetje të grave “Dora Dorës” nga Prizreni.

Në tryezën e rrumbullakët ishin prezantuar rezultatet dhe rekomandimet nga hulumtimi “**Gjendja me barazinë në tregun e punës dhe dinjteti, integriteti dhe dhuna e bazuar mbi gjininë në rajonin e Pollogut**”, ndërkohë, gjithashtu u shpërndanë/prezantuan edhe të dhëna nga hulumtimi i gjendjes në këto sfera në Kosovë.

Përveç rekomandimeve nga hulumtimi, në kuadër të diskutimit dolën dhe konkluzionet dhe rekomandimet që vijnë në lidhje me tre çështje kyçe mbi të cilat diskutohej:

### **Çfarë politikash dhe programesh për punësim, inkurajim të sipërmarrjes së grave dhe ulje/ reduktim të varfërisë janë të nevojshme në nivel lokal?**

- **Mungesa e integritetit sistematik të barazisë gjinore në politikat për punësim përbën faktor kufizues për efikasitetin dhe efektivitetin e tyre.**

Edhe pse barazia gjinore është imperativ dhe egzistojnë qëllime për rritjen e përqindjes së grave të punësuar në politikat aktuale për punësim, përfshirë dhe politikat dhe masat aktive, statistika nacionale dhe analizat gjinore për vite me radhë konstatojnë mundësi të pabarabarta për gratë në tregun e punës; shkallë të lartë të pasivitetit ekonomik, segregim/ndarje horizontale dhe vertikale, pabarazi në pagat, varfëri në punësim.



Gjithashtu mungojnë programe dhe masa të specializuara në të cilat grup qëllimor janë kategori të ndryshme të grave, njëkohësisht mungojnë edhe tregues gjinorë dhe kriteriume specifike që do të sigurojnë qasje të barabartë dhe mundësi për shfrytëzimin e këtyre masave nga ana e grave.

- **Llojet/tipet e ofruara dhe metodologjia në zbatimin/implementimin e programeve dhe masave aktive për punësim janë në një disonancë të lartë me nevojat dhe potencialet e grave.**

Fuqizimi ekonomik i grave po bëhet temë gjithnjë e më aktuale kohët e fundit, gjë që përbën një tendencë/prijje pozitive. Megjithatë, nga ana tjetër, enti shtetëror për statistikë rregjistron rritje të numrit të grave ekonomikisht joaktive, veçanërisht tek gratë nga 35 deri në 49 vjeçe, që përbën alarm se politikat aktive, përfshirë këtu edhe programet dhe masat për inkurajimin e sipërmarrjes, nuk u përgjigjen nevojave në teren.

Gjatë përgatitjes së politikave nacionale është e nevojshme të merren parasysh specifikat lokale, sfidat dhe nevojat e grave. Gjithashtu, në nivel lokal egziston praktika e trajtimit të grave si një nga grupet e marginalizuara, që përbën një qasje joadekuate.

Është e nevojshme vendosja/krijimi i parakushteve të domosdoshme që gratë të mundën t'u përkushtohen aktiviteteve ekonomike, sepse qasja e kufizuar ndaj shërbimeve lokale (uji, energjia elektrike, transporti publik, kopshte/çerdhe fëmijësh, qendra për personat me nevoja të posaçme, pleq dhe persona me aftësi të kufizuara) e mbingarkon përditshmërinë e grave, veçanërisht të grave të zonave rurale, dhe bashkë me informimin dhe pjesëmarrjen e pamjaftueshme e bën të pamundur realizimin e interesave të tyre ekonomike dhe interesave të natyrave të tjera.

Programet dhe masat aktuale duhet të "priten dhe qepen" në mënyrë të tillë që të mund të sigurojnë shfrytëzimin e potencialit të grave. Fakti që këto masa nuk janë adekuate më së miri ilustronet nëpërmjet pyetjeve të llojit: Vallë me të vërtetë grave u nevojiten kurse për gjuhë angleze dhe kompjuterë, kur ato janë të papunësuar për një kohë të gjatë? Me të vërtetë u mungon gjuha angleze për t'u punësuar, dhe ku do të punësohen pas kursit? Nëse ndaj lokacionit ku do të mbahen kurset kanë qasje të gjitha gratë? A do mundet një grua nga Brvenica të ndjekë kurs në Tetovë, po ta kemi parasysh infrastrukturën e keqe?

Është e nevojshme të kapërcehen paragjykimet kulturore ndaj grave në biznes. Gratë e reja zakonisht dalin nga korniza e stereotipeve kulturore, pjesa më e madhe e tyre janë të informuara mirë dhe të arsimuara në mjedise më të mëdhaja. Gratë duhet të shihen si resurs dhe potencial, dhe jo si një kategori e dobët / e varfër të cilës i nevojitet ndihmë. Në Maqedoni ka një numër shumë të madh të grave joaktive, që përfaqëson resurs të pashfrytëzuar. Sipërmarrja e grave duhet të promovohet sistematikisht. Gratë e suksesshme duhet të promovohen si modele, sepse ata me autoritetin e fituar në bashkësi, kanë kapacitet të tërheqin me vete një grup të tërë grash, të negociojnë me komunën, etj. Përvojat nga realizimi i programeve për fuqizim ekonomik nëpërmjet inkurajimit të sipërmarrjes tregojnë se një pjesë e madhe e grave posedojnë shkathtësi të cilat janë të kërkuara në treg, por ajo që u nevojitet është qasja ndaj informacioneve, mbështetje e specializuar sistematike mbi bazën e nevojave të identifikuara në vend të trajnimeve të shkëputura dhe jo në kontinuitet, financa/ paisje, marketing dhe qasje ndaj tregjeve etj.

Është e nevojshme të merret parasysh fakti që shpesh, gratë vetëm figurojnë si bartëse të biznesit, ndërkohë që kontrolli ose mbështetja është tek bashkëshortët e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes. Për këtë arsye, është e nevojshme qasje që do të mundësojë mbështetje për gratë për menaxhim të pavarur të biznesit të tyre.

Politika tatimore dhe qasja e pamjaftueshme ndaj mjeteve financiare janë faktor kufizues për një pjesë të madhe të grave të cilat duan t'i formalizojnë, t'i mirëmbajnë ose zhvillojnë bizneset e vogla nëpërmjet shitjes së produkteve të tyre në tregjet e huaja. Pagesat/ tarifat e larta i shterin,



a kreditë janë të paarrishme/ të pakapshme për arsye se nuk posedojnë pasuri në emrin e tyre, gjë për të cilën nevojiten skema grantesh të shoqëruara me masa për mbështetjen e formalizimit dhe zhvillimit të bizneseve.

Është e nevojshme të identifikohen dhe përshtaten modele/ qasje/përvoja të cilat në shtetet e rajonit ose BE –së janë treguar si praktika të mira përse i përket mbështetjes së fuqizimit ekonomik dhe sigurimit të barazisë për gratë në tregun e punës, duke e përfshirë edhe promovimin e barazisë tek biznes komuniteti dhe sigurimin e qasjes së barabartë të bizneseve të grave ndaj prokurimit publik.

- **Mungon promovimi sistematik i politikave/programeve/masave autentike lokale për fuqizimin ekonomik të grave.**

Planet për ZHEL (zhvillim ekonomik lokal) të disa NJVQ (Njësive të Vetëqeverisjes Lokale) përmbajnë masa për fuqizim ekonomik, por nuk janë siguruar mjete financiare nga buxheti për realizimin e tyre. Nuk janë të pranueshme justifikimet se komunat nuk kanë mjete financiare sepse analizat buxhetore dëshmojnë për alokime/transferta të larta buxhetore për të cilat nuk janë të njohur as përdoruesit dhe as qëllimi, ose janë në kundërshtim me prioritetet e identikuara të qytetarëve, veçanërisht të grave.

Inisjativat me potencial të vërtetuar/dëshmuar për punësim të qëndrueshëm të grave që sjell të ardhura dinjitoze, në pjesën më të madhe/kryesisht janë inicuar në kuadër të projekteve të financuara nga ndihma për zhvillim. Me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e tyre, është e nevojshme ato të mbështeten nëpërmjet integritit të tyre në politikat lokale për zhvillim ekonomik dhe financimi i tyre të bëhet nga buxheti i vetëqeverisjeve lokale. Gjithashtu, qëndrueshmëria mund të sigurohet edhe nëpërmjet integritit të tyre si modele/ masa në kuadër të planeve për punësim dhe buxhet të pushtetit qëndror.

**Si të përmirësohet efikasiteti i mbrojtjes nga ngacmimi seksual, mobingu dhe forma të tjera të diskriminimit mbi gratë gjatë punësimit dhe në vendin e punës?**

- **Diskriminimi dhe dhuna mbi gratë në tregun e punës (mobingu mbi gratë dhe veçanërisht ngacmimi seksual) janë pyetje që mungojnë si faktor ndikimi për pabarazinë dhe hendekun gjinor në politikat për punësim.**

Papunësia e lartë dhe pasiguria në vendet e punës për shkak të natyrës/llojit të kontratave për punësim janë faktorët kryesorë që ndikojnë në diskriminimin mbi gratë në vendin e punës.

Natyra dhe pasojat nga forma të ndryshme të diskriminimit mbi gratë dhe thyerja e të drejtave të tyre nga sfera e marrëdhënieve të punës, veçanërisht mobingu dhe ngacmimi seksual nuk duhet më të shpërfillen/ nënvleftësohen. Pasojat për gratë – viktimat të një lloji të tillë dhune janë të natyrave nga më të ndryshmet: psikologjike, financiare, humbje e vendit të punës, pozicion më të ulët në vendin e punës, më shumë angazhime/detyra në vendin e punës, detyra jo adekuate në vendin e punës, zvogëlim i koncentrimin në punë, presioni i vazhdueshëm për t'ju shmangur dhunuesit në orarin e punës etj. Gratë të cilat ndeshen me problem të kësaj natyre ose kërkojnë vetë të dalin nga puna, ose janë shkarkuar nga puna. Por, fakt është se gratë i humbasin vendet e tyre të punës për shkak të ngacmimit seksual, viktimat të të cilit janë ata vetë.

Profili i viktimave i përfshin gratë e reja, gratë të cilat janë punësuar me kontratë gojore ose honorare, gratë në sektorin privat, por edhe gratë të cilat ndodhen në pozicionet e mesme ose të ulëta (hierarkike) në firmën.



Është i nevojshëm harmonizimi terminologjik në ligjet që e trajtojnë çështjen e ngacmimit seksual me definicionin e Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe futja e mekanizmave të specijalizuara për operacionalizim efikas të mbrojtjes.

Mungesa e një sistemi efikas të mbrojtjes, veçanërisht në sektorin privat, problemet e lidhura me pamundësinë për t'a dëshmuar/treguar diskriminimin dhe shqetësimin seksual, si dhe kufizimet kulturore, ndikojnë mbi numrin jashtëzakonisht të ulët të rasteve të denoncuara nëpërmjet mekanizmave të vendosura nga ana e disa organizatave të shoqërisë civile.

Mbrojtja sindikale gjithashtu është jofunksionale për arsye se implementimi i asaj që është miratuar si ligj dhe rregullativë nuk funksionon në praktikë. Sindikatet duhet të funksionojnë më mirë, gjë për të cilën më e mira është që sindikatet e veçuara të bashkohen dhe të marrin pozicionin e mbrojtjes reale të të drejtave të punëtorëve. Mekanizmat për mbështetje në kuadër të sindikatave nuk mund të ofrojnë më shumë se mbështetja psikologjike dhe këshillime. Gjegjësish, pamundësia e konfirmimit të rezultatit pozitiv për gratë nga proceset gjyqësore, sepse dëshmimi i rasteve të tilla është shumë i vështirë. Janë të nevojshme shumë punëtori, debate publike dhe trajnim për punëdhënësit, veçanërisht trajnime për stafet e menaxherëve.

**Cili është kontributi i mundshëm i shoqatave të qytetarëve në përmirësimin e pozicionit të gruas në tregun e punës**

Edhe pse konteksti politik është vlerësuar si tejet i pavolitshëm për veprimtarinë e shoqatave të qytetarëve, konkluzioni është se organizatat joqeveritare, veçanërisht ata që veprojnë në bashkësitë lokale, munden , madje në një masë të madhe, të ndikojnë në përmirësimin e tretmanit për fuqizimin ekonomik të grave si fokus i politikave të ardhshme në sferën e punësimit. Fonde ka, por ato janë shumë të vogla ose të planifikuara në sferën e inkuadrimin social, gjë për të cilën është e nevojshme veprimtari e cila politikat do t'i fokusojë/përqëndrojë në mënyrë të barabartë edhe drejt grave të reja të arsimuara edhe drejt kategorive të grave të marginalizuara.

Nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me gratë e komunitetit OJQ-të munden të ndihmojnë për identifikimin e nevojave specifike dhe potencialeve të grave, për sigurimin e informacioneve për mundësitë dhe për mbështetje, si dhe përfaqësim të shërbimeve sociale relevante të financuara në mënyrë publike.

Është e nevojshme përfshirje më e madhe e shoqatave të qytetarëve në aspektin e promovimit sistematik, nxitje dhe përfaqësim të masave dhe fondeve për zhvillim të sipërmarrjes femërore.

Sipërmarrja sociale dhe transferi i ingerencave nga ana e vetëqeverisjes lokale si mundësi për sigurimin njëkohësisht të shërbimeve dhe qasjes ndaj punësimit të kategorive të pambrojtura të grave, gjithashtu përfaqëson mundësi për përfshirje më të madhe të shoqatave të qytetarëve në mbështetjen e barazisë gjinore. Shkëmbimi reciprok i informacioneve dhe i përvojës, si dhe bashkëpunimi në nivel nacional dhe lokal i cili është në funksion të përfaqësimit efektiv të legjislacionit dhe politikave nga sfera e punësimit, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna në bazë gjinore, është një nga format e qasjes.

Në kuadër të debatit ishin vënë në pah edhe përfitimi nga efektet e dukshme të mbështetjes së kapaciteteve të organizatave të përfshira në projekt si dhe shkëmbimi i përvojave dhe informacioneve ndërmjet organizatave partnere dhe organizatave të tjera për menaxhimin me sfidat e përbashkëta nga sfera e të drejtave të grave dhe barazia gjinore. Ndërkohë, u theksua nevoja për të vazhduar bashkëpunimi ndërkufitar edhe pas mbarimit të projektit.

